



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



i	Data	27-04-22	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01-104/02-11323/22				



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

ZYRA E KRYETARIT

Kaçanik, 26.04.2022

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve

1. Komuna e Kaçanikut-Zyra e Kryetarit të kmunës duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.-04/2017 Mbi kriteretm standardet dhe procedurat e finanncimit publik te OJQ-ve, fton gjitha organizatat jo-qeveritare të Regjistruara në Repubikën e Kosovëspër, e me bazë në Komunën e Kaçanikut për aplikim për mbështetje financiare-subvencionim të tyre, programi i punës i të cilave është i fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve këshilluese, avokuese dhe ofrimin e drejtëpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet e tyre të cilat duhet të kenë për objektiv zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, respektivisht kujdesit, evokimit dhe këshillimit të personave-kategorive të dalura nga lufta e UÇK-së.

3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 3,000.00 euro.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 3,000.00 euro.

4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën 13.05.2022.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale *ndaj ofruesit të mbështetjes financiare* dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të *ofruesit të mbështetjes financiare* web faqja: www.kk.rks-gov.net/kaçanik te rubrika: **Shpalljet**

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në sportelin nr.4 te objektit te komunës.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Kryetari i komunës:

Besim Ilazi

